

Shtëpia e Librave shok

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

01.01.2018 – 31.12.2018

Shoqëria **Shtëpia e Librave shpk** i ka ndërtuar Pasqyrat Finaciare për vitin 2018 në bazë të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK 15. **Shtëpia e Librave shpk** kryen shërbime shitje dhe shpërndarje të librave përmes faqes së saj online dhe fizikisht. Gjithashtu, **Shtëpia e Librave shpk** ka zhvilluar edhe procese të botimit të librave.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur duke ndjekur e zbatuar:

Politikat Kryesore Kontabël:

Politika për njohjen e aktiveve, për njohjen e detyrimeve, njohjen e të drejtave, njohjen e të ardhurave e shpenzimeve dhe vlerësimin e tyre.

Parimet Kontabël:

Parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, Parimi i Njësisë Ekonomike Raportuese, Parimi i vijimësisë së veprimtarisë ekonomike si dhe Parimi i Kompensimit.

Karakteristikat cilësore të informacionit Kontabël:

Karakteristikat kryesore që janë mbajtur parasysh gjatë hartimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2018 janë: Kuptueshmëria, Rëndësia dhe Materialiteti, Besueshmëria, Parimi i Paraqitjes me Besnikëri, Parimi i Përparësisë së përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore, Paanshmëria, Parimi i maturisë, Parimi i plotësisë, qëndrueshmërisë dhe krahasueshmërisë .

BILANCI KONTABËL

AKTIVI I BILANCIT

Shënimi 1:

Mjete monetare

Nr.	Emertimi bankës	Numri llogarisë	Shuma në monedhë e huaj	Kursi I kembimit datë 31.12.2013	Shuma ne lekë
1	Raiffeissen Bank Lekë				46'828
2	Raiffeissen Bank Euro		1721.8	123.42	212'505
3	Arka në lek				13'533
Shuma					272'865

Shënimi 2:

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme në një vlerë prej 0 lekësh që përfaqësojnë të gjitha vlerat e përfituara nga njësia ekonomike nga klientët e saj. Njësia ekonomike ka arkëtuar të gjitha shërbimet që u ka kryer klientëve të saj.

Shënimi 3:

Aktive Afatgjata materiale

Aktive Afatgjata materiale arrijnë vlerën prej 29'665 lekësh. Ky zë përbehet nga mobilje (tavolinë), kasa fiskale dhe laptop të cilat i shërbejnë aktivitetit normal te kompanisë. Këto aktive janë amortizuar në bazë të normave të amortizimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.

DETYRIMET DHE KAPITALI I VET

Shënimi 5:

Detyrime Tregtare

Vlera prej 1'965'451 lekë përbën detyrimin e kompanisë ndaj organeve tatimore dhe furnitorëve në lidhje me:

- Shumën e ***sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore*** me vlerë 22'638 lekë të llogaritur dhe të mbajtur nga kompania për llogari të punonjësve të saj;
- ***Të pagueshme ndaj furnitorëve*** me vlerë 31'969 lekë e cila do të likuidohet gjatë vitit në vazhdim;
- ***Hua nga ortakut i vetëm*** me vlerë 1'880'550 lekë, e dhenë hua nga ortakut për kompaninë me interes 0 (zero);
- ***Detyrime tatimore për Tatimin në Burim*** në një vlerë prej 5294 lekë e cila përfaqëson tatimin mbi shërbimet e konsulencës të ofruara nga njësia.
- ***Detyrime për tatim fitimin në vlerën prej 25'000 lekësh.***

PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas Parimit të Kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogariten me besueshmëri.

Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin periudhë kontabël me të ardhurat e lidhura.

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve e ndërtuar sipas Natyrës.

Shënimi 6:

Të Ardhurat

Të ardhurave janë në vlerën e 2'262'468 lekë, që përfshinë të ardhura të realizuara nga shitja e librave.

Shënimi 7:

Shpenzimet

Shpenzimet e kompanisë gjatë vitit financiar 2014 janë në vlerën 2'106'552 lekë. Vlerën më të lartë të shpenzimeve e zënë shpenzimet për produktet e shitura me vlerë 1'039'246 lekësh.

Rezultati i periudhës ushtrimore është pozitiv, duke rezultuar në fitim prej 130'915 lekësh.

Administrator

Gjergj Erebara